



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

SHPALLJE PËR POZICIONIN SPECIALIST

Në zbatim të Vendimin Nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, si dhe të Urdhrit të Kryeministrat nr. 94, datë 12.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

2 (dy) Specialistë të Sektorit të Koordinimit & Menaxhimit të Projekteve, Programeve, Fondeve me Financim të Huaj, në Drejtorinë e Planifikimit, Koordinimit dhe Fizibilitetit, në Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve

Afati për dorëzimin e dokumenteve 28/06/2024 pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Bashkëpunon me pushtetin vendor për koordinimin dhe monitorimin e projekteve për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, nëpërmjet sistemit të raportimit periodik të raportimit dhe mbledhjes së të dhënave.
- Identifikon dhe propozon projekt ide përfushën e mirëmenaxhimit të mbetjeve për financim nga donatorë të huaj.
- Ndjek procesin e përgatitjes së projekt propozimeve në kohë dhe më cilësi për thirrjet respektive për projekte me financim të huaj.
- Ndjek zbatimin i rregullave dhe procedurave teknike të projekteve me finacim të huaj, që do të kontribojnë në kalimin nga ekonomia lineare drejt një ekonomie qarkulluese.
- Ndjek dhe monitoron ecurinë e projekteve në proces implementimi si dhe koordinon punën për përgatitjen e raportimeve financiare për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Financës së AKEM dhe MTM si dhe raportimet e ndryshme periodike, sipas marrëveshjeve respective të nënshkruara.
- Ndjek dhe përgatit raporte për realizimin e aktivitetave për projektet me financim të huaj.
- Koordinon në bashkëpunim më Bashkitë dhe donatorët respektivë implementimin e projekteve dhe kontribon në koordinimin ndërinstitucional, në përpunim me projekt dokumentin e miratuar.

KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pranim si dhe kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
 - b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c. Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë të studimeve, të nivelit “Master Shkencor”/ “Master Profesional”, në shkenca Shoqërore/Juridike/Ekonomike;
 - d. Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
 - e. Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - f. Të mos ketë konflikt interes i në ushtrimin e detyrës;
-
- g. Të ketë njohuri shumë të mira profesionale të çështjeve teknike dhe aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi;
 - h. Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
 - i. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
 - j. Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja
 - k. Të kenë aftësi të mira menaxheriale dhe të procedurave administrative;
 - l. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
 - m. Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
 - n. Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
 - b- Fotokopje të diplomës/diplomave dhe listes se notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
 - c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (në momentin e fillimit të marrëdhënieve të punës);
 - f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 - g. Dy referenca nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë të mëparshëm;
 - gj. Certifikata për trajnime në lidhje me pozicionin për të cilin konkurojnë;
 - h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në vitin e fundit;
 - i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrinin tuaj;
- Dokumentat duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në MTM brenda datës 28/06/2024

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Komisioni Ad-Hoc do të shpallë në faqen zyrtare të MTM-së www.turizmi.gov.al, tek kategorija/menuja “Njoftimet”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme

për intervistën e strukturuar me gojë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të intervistohen për njojuritë mbi dokumentet e listuara më poshtë:

- Njojuritë mbi Ligjin nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar;
- Njojuritë mbi Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar;
- Njojuri mbi VKM-në nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”;
- Njojuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";
- Njojuritë mbi Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Njojuri mbi Vendimin Nr. 132, datë 6.03.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen edhe në lidhje me:

- a- Njojuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë drejtuese;
- b- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE KOMUNIKIMI

Kandidatët do të vlerësohen me pikë si më poshtë:

- a- Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë;
- b- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në MTM do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të ministrisë.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentacioneve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 28.06.2024 në protokollin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

Zhvillimi i intervistës do të zhvillohet në datën 8.07.2024, në ambientet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;